

SHOQËRIA "T & XH" SH.P.K.

NUIS : L72121504I

**Adresa: Rr.Kongresi Manastirit, ZK 8514, Pasuria nr.1/432, Hyrja -1 (Prane Kapedanit),
Durrës.**

E-mail: contact@txhshpk.al

VENDIM

DATË 12.04.2023

**I ASAMBLESE SË ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË TREGTARE "T & XH" SH.P.K.**

Sot më datën 12, muaji Prill, viti 2023, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "T & XH" SH.P.K., në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Vlerësimi i situatës në lidhje me kapitalin, fitimet dhe rezervat e pashpërndara.

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, Z. Përparim Cena, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E:


Shoqëria Tregtare "T & XH" SH.P.K, është themeluar më datë 15.09.2017 dhe është rregjistruar pranë Qendres Kombëtare të Biznesit, më datë 21.09.2017, me Ortak të Vetëm dhe Administrator Z.Përparim Cena, i cili zotëron 1 (Një) kuotë (pjesë) kapitali që përbën 100 % të kapitalit të nënshkruar, të kësaj shoqërie në vlerën 5 000 000 (pesëmilionë) Lekë.

Në vështrim të rendit të ditës, si dhe në bazë të Statutit, Aktit të Themelimit dhe Ligjit "Për tregëtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Ortaku i Vetëm, konstaton se për ecurinë më të mirë të shoqërisë në të ardhmen, për të patur një vazhdimësi të qëndrueshme, dhe siguri të veprimtarisë, si dhe për të rritur treguesit financiarë, rezervat e tjera dhe fitimet e pashpërndara, gjendje sipas bilancit të shoqërisë më 31.12.2022, në shumën 74 962 845 lekë, ti kalojë:

1. Për zmadhim të kapitalit aksionar të kësaj shoqërie, vlerën 69 000 000 Lekë,
2. Për shtimin e rezerva ligjore, vlerën 5 962 845 lekë.

Në bazë të këtij kalimi, zmadhimi i kapitalit të nënshkruar të shoqërisë bëhet nga vlerën 5 000 000 (pesëmilionë) Lekë, në 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë, e barabartë kjo me 1 (Një) kuotë (pjesë) kapitali, me vlerë nominale prej 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:



Z.Përparim Cena, do të jetë zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit të nënshkruar, i cili do të përbëhet nga 1 (një) kuotë (pjesë) kapitali, me vlerë nominale prej 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë.

Për këto arsye, Asambleja e Ortakut të Vetëm të shoqërisë,

V E N D O S I :

1. Zmadhimin e kapitalit të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 5 000 000 (pesëmilionë) Lekë, në 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë, e barabartë kjo me 1 (Një) kuotë (pjesë) kapitali. Zmadhimi i kapitalit të shoqërisë bëhet, nga rezervat e tjera dhe fitimet e pashpërndara, gjendje sipas bilancit të shoqërisë më 31.12.2022.
2. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 5 000 000 (pesëmilionë) Lekë, në 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë.
3. Z. Përparim Cena, do të jetë zotërues i 100 % të kapitalit të nënshkruar të shoqërisë "T & XH" SH.P.K , i cili do të përbëhet nga 1 (një) kuotë (pjesë) kapitali, me vlerën nominale prej 74 000 000 (shtatëdhjetë e katërmilionë) Lekë.
4. Depozitimim e këtij vendimi pranë Qendres Kombetare të Biznesit .

ASAMBLEJA E ORTAKUT TË VETËM

TË SHOQËRISË TREGTARE "T & XH" SH.P.K

Përparim CENA

